



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4883 prot

Roskovec, më 01.07.2024

VENDIM

NR 41 .DATË 28.06.2024

***“PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË DISA RRUGËVE DHE EMËRTIMIN E
SHESHEVE NË BASHKINË ROSKOVEC”***

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 54 shkronja II), të ligjit Nr. 9270 datë 29.07.2004 “Për Sistemin e Adresave” (i ndryshuar), neni 3, neni 4/1 pika 1, neni 5 dhe neni 6; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- Njësia Roskovec
 - Rruga me emërtimin rruga e “Kanalit ” të ndryshohet me emërtimin rruga **“Faslli Dyle ”**.
 - Rruga me emërtimin “Braçallarët “ në fshatin Jagodinë të ndryshohet me emërtimin e rruga **“Braçe Kapo ”**.
- Njësia Administrative Kuman
 - Rruga me emërtimin “Kaçeli “ në fshatin Marinëz të ndryshohet me emërtimin rruga **“Nasi Mita ”**.
 - Miratimin për emërtimin e sheshit që ndodhet në hyrje të lagjes së kodrës në fshatin Marinëz me emrin sheshi **“ Mihal Poshnjari ”**.
- Njësia Administrative Kurjan
 - Rruga me emërtimin “Metohu “ në fshatin Kurjan të ndryshohet me emërtimin rruga **“Alush Metohu ”**.

Emrat për miratimin e rrugëve plotësojnë kriteret ligjore për emërtimin e një rruge sepse:

- Emrat e miratuar janë të personaliteteve të dëgjuar në komunitet.
 - Personat kanë ndërruar jetë.
 - Këto emërtime janë unike dhe nuk janë përdorur për emërtime të tjera në pjesë të territorit të bashkisë Roskovec.
- Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Zyra e Gjendjes Civile Roskovec për zbatimin e këtij vendimi.
 - Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Afrim Plaka

